

Partnerët Shqipëri hap thirrjen për aplikime për eventin "RRATHË DHURUES" (GIVING CIRCLE)



#RrathëDhures
Shqipëri

A keni një ide inovatore që mund të përmirësojë cilësinë e jetës së një komuniteti të caktuar por nuk keni para?
Jeni duke zbatuar një nismë konkrete në komunitet por nuk keni burime të mjaftueshme?

Kjo është mundësia e duhur për ta vënë në praktikë idenë tuaj!

Partnerët Shqipëri hap thirrjen për aplikime për të gjitha OJF-të që kanë një ide konkrete apo nismë në zbatim për të sjellë ndryshim social në një komunitet të caktuar, përmes mbështetjes edhe nga vetë komuniteti. Tre idetë më të mira do të përzgjidhen për t'u zbatuar duke fituar mbështetje financiare dhe në natyrë përmes një ankandi (live crowdfunding) gjatë eventit "Rrathë Dhures" i cili do të organizohet për herë të dytë në Shqipëri në **Maj 2020**.

Çfarë është eventin "Rrathë Dhures"

Rrathë Dhures vjen për të dytin vit radhazi si një event i cili mbledh së bashku individë nga fusha të ndryshme duke vënë në dispozicion ekspertizën, kohën dhe burimet financiare për të mbështetur projekte/kauza konkrete që sjellin ndryshime sociale në komunitete të caktuara.

Partnerët Shqipëri do të zbatojë këtë nismë inovatore sipas komponentëve të mëposhtëm:

- Hapja e thirrjes për aplikime për OJF** të cilat kanë një ide inovative apo nismë konkrete në zbatim për të kontribuar apo ndikuar në komunitete të caktuara;
- Përzgjedhja e 3 ideve më të mira** të cilat synojnë sjelljen e një ndryshimi në komunitetet e targetuara;
- Trajnimi i përfaqësuesve të ideve fituese** për të realizuar një prezantim të suksesshëm gjatë eventit;
- Prezantimi i idesë në event** - çdo ide do të prezantohet dhe do t'ju përgjigjet pyetjeve të audiencës brenda 12 minutave. Mbështetësi i çdo ideje do të prezantohet qëllimisht dhe do të motivojë audiencën që t'i bashkohet kësaj kauze. Moderatorin e eventit do të ftojë audiencën të dhurojë për secilën nga idetë e përzgjedhura. Dhurimet llogariten live derisa të arrihet shuma e synuar. Shuma e targetuar për secilën ide është minimumi 300,000 lekë.
- Promovimi i ideve të financuara**. Tre idetë e financuara do të promovohen gjerësisht përmes të gjitha kanaleve të komunikimit për të promovuar zbatimin dhe rezultatet e ndërhyrjeve.

Përse duhet të aplikoni

- Mundësi për promovimin e punës / idesë suaj para një audience të gjerë dhe të zgjedhur;
- Mundësi për tërheqjen e mbështetësve të rinj dhe krijimin e partneriteteve të reja;
- Ka gjithmonë e më pak burime financiare në dispozicion për projekte komunitare;
- **Bashkimi bën fuqinë!** Nëse të gjithë mbledhen bashkë dhe dhurojnë pak, impakti është më i madh.

Procesi i Aplikimit


- Thirrja është e hapur për të gjitha OJF-të që kanë një ide inovatore apo nismë në zbatim e sipër që ka qëllim përmirësimin e jetës së komuniteteve të caktuara;
- Kandidatët e interesuar janë të ftuar të aplikojnë duke plotësuar Formën e Aplikimit;
- Afati për dërgimin e aplikimeve është data **2 prill 2020**, ora **17:00** në adresën: jalite@partnersalbania.org

Përzgjedhja

- Tre idetë fituese që do të marrin pjesë në eventin "Rrathë Dhures" do të përzgjidhen nga një juri profesionistësh, përfaqësues të sektorëve të ndryshëm.
- Ideja/projekti duhet të zgjidhë një nevojë konkrete dhe të ketë impakt të dukshëm në një komunitet apo komunitete të caktuara;
 - Ideja duhet të ketë mbështetjen e komunitetit dhe ta përfshijë atë;
 - Çdo aplikant duhet të sigurojë një mbështetës kryesor si pjesë e procesit të aplikimit, të cilët besojnë tek iniciativa dhe kontribuojnë financiarisht apo në natyrë (pavarësisht shumës).
 - Iniciativat fituese duhet të angazohen në sigurimin edhe të mbështetësve të tjerë, që duhet të jenë pjesë e eventit.

Një pasqyrë e eventit të parë "Rrathë Dhurues"

Eventi i parë Rrathë Dhurues mbledhi së bashku përfaqësues të lartë të sektorit të biznesit, komunitetit të donatorëve, institucioneve diplomatike, shoqërisë civile, medias, artit etj., të cilët ofruan mbështetje financiare dhe materiale në vlerën **1,885,874 Lekë**, për tre iniciativa të cilat sollën ndryshime të qëndrueshme sociale për komunitete në nevojë.



Një kopsht për fëmijët e fshatit Bllaçë!

Një iniciativë e VIZION OJF

Përmes mbështetjes së siguruar gjatë dhe pas eventit u mundësua rinovimi i ambienteve të kopshtit (sistemi elektrik, ngrohës, shtrimi i dyshemesë dhe suvatimi i mureve), pajisja me tavolina e karrige të reja, mjete didaktike për mbarëvajtjen e mësimit, si dhe lodrat e nevojshme për zhvillimin psiko-social të 42 fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç, frekuentues të kopshtit Bllaçë, Peshkopi!

[kliko mbi imazh për më shumë mbi iniciativën](#)



Edukimi dhe integrimi i fëmijëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian përmes sportit

Një iniciativë e shoqatës për të Drejtat e Komunitetit Rom dhe Egjiptian, Shkodër

Mbi 30 fëmijë të komunitetit Rom dhe Egjiptian, të grupmoshës 10-13 vjeç, pjesë e ekipit sportiv U-13 në Shkodër, prej muajsh disponojnë pajisjet dhe ambientet e duhura stërvitore. Ekipi vijon të krijojë një shembull pozitiv në komunitet duke nxitur ndjenjën e përfaqësimit për anëtarët e këtyre komuniteteve, uljen e braktisjes së shkollës, minimizimin e bullizmit dhe promovimin e rregullave 'fair-play' në fushë dhe në jetë për këta fëmijë të talentuar.

[kliko mbi imazh për më shumë mbi iniciativën](#)



Adopto një terapi!

Një iniciativë e Down Syndrome Albania

Fondacioni Down Syndrome Albania (DSA) ofroi shërbime për 37 fëmijë me Sindromën Down, fëmijë në çrregullimin e spektrit të Autizmit dhe vështirësi të tjera në të nxënë përmes mbështetjes së ofruar gjatë dhe pas eventit "Rrathë Dhurues". Çdo dhurim ndihmoi në ofrimin e shërbimeve të domosdoshme për këta fëmijë për t'u mundësuar atyre zhvillimin drejt një jete të pavarur dhe gjithëpërfshirëse.

[kliko mbi imazh për më shumë mbi iniciativën](#)



Eventi Rrathë Dhurues 2020 mbështetet nga Bashkimi Evropian nëpërmjet Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri si pjesë e aktiviteteve të projektit "EMBRACE – Modele Sipërmarrjeje që ndërtojnë Marrëdhënie dhe Ekonomi Krijuese", Rockefeller Brothers Fund, Frederick Mulder Foundation dhe The Funding Network.